



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga
Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Financuar nga:

Austrian
Development Cooperation

Kumtesë për Media

21 organizata të grave marrin grante në vlerë 64.400 € nga Fondi i Grave të Kosovës

Rjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) ka nënshkruar kontratat me 21 organizata anëtare, përfituese të 17 granteve, disa prej të cilave janë partneritete të këtij rauti (nëntë) të Fondit të Grave të Kosovës (FGK), në vlerë prej 64,400 €. Këto projekte do të kontribuojnë në zbatimin e [Strategjisë së RrGGK 2015-2018](#). Ky raund mbështetet financiarisht nga Austrian Development Agency (ADA) (23,451 €) dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (40,949 €).

Përfituesit e granteve të Fondit të Grave të Kosovës janë:

Grant Avokimi Individual për një Organizatë:

- OJQ Artpolis - Iniciativa: "FEMART – Festivali i artisteve për të drejtat e njeriut"; Komuna e Prishtinës (2,900.00 €)
- Qendra e Kosovës për Zhvillim dhe Integrim Mulbtikulturor (QKZHM) – Iniciativa: "Fuqizimi ekonomik i të rinjëve (të diplomuarve) nga komunitetet jo-shumicë: Romë, Ashkali, Egjiptian në Komunën e Gjakovës me fokus femrat e këtyre komuniteteve"; Komuna e Gjakovës (2,980.00 €)
- OJQ Venera - Iniciativa: "Prona të takon me ligj, kërkoje se nuk është turp"; Komuna e Pejës (2,944.50 €)
- Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut (MWAHR) - Iniciativa: "Gratë udhëheqëse"; Komuna e Mitrovicës Veriore (3,000.00 €)
- OJQ Dita – Iniciativa: "Promovimi i të drejtave të grave dhe fuqizimi i rolit të tyre në trashëgiminë pronësore"; Komuna e Gjilanit (2,968.00 €)
- OJQ Mbrojtje të Drejtat Tua – Iniciativa: "Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje"; Komuna e Deçanit (2,865.25 €)
- Fondacioni për Edukim dhe Zhvillim (FEZh) – Iniciativa: "Gjuhë të ndryshme, qëllimi i përbashkët"; Komuna e Shtërpces (2,855.00 €)
- OJQ Speranza – Iniciativa: "Edukimi dhe vetëdijësimi mbi dhunën në familje"; Komuna e Mitrovicës (2,929.00 €)
- Shoqata e Femrave të Shurdhëra (ShFSh) - Iniciativa: "Gruaja në shëndetësi"; Komuna e Prizrenit (2,966.00 €)
- OJQ Vita-Jeta - Iniciativa: "Osteoporozë te gratë e moshës postmenopauzale"; Komuna e Prishtinës (2,965.00 €)
- OJQ Dora-Dorës – Iniciativa: "Zhvillimi i politikave gjinore në Komunën e Mamushës"; Komuna e Mamushës (2,944.40 €)
- OJQ Gruaja Bashkëkohore - Iniciativa: "Jo vetëm numër"; Komuna e Prizrenit (2,581.00 €)
- OJQ Education Code – Iniciativa: "Edhe gratë mund të gjenerojnë të hyra nga bujqësia"; Komuna e Prishtinës (2,999.00 €)

Implementuar nga:



Grante Avokimi në Partnership për Ndryshim:

- OJQ Flaka & OJQ Parajsa jonë; Iniciativa: “E drejta e grave në trashëgimin e pronës”; Komuna e Lipjanit (6,911.00 €)
- Femrat Aktive të Gjakovës (FAGj) & Iniciativa për Integrim të Komuniteteve (IPIK); Iniciativa: “Fuqizimi i grave përmes rritjes së vetëdijësimit rreth të drejtave pronësore dhe trashëgimore në Komunën e Gjakovës dhe Dragashit”; Komuna e Gjakovës dhe Dragashit (6,650.00 €)
- Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) & OJQ ATO; Iniciativa: “Fuqizimi ekonomik dhe ngritja e kapaciteteve të grave në viset rurale në Komunën e Vushtrrisë”; Komuna e Vushtrrisë (6,990.00 €)
- OJQ Rikotta & OJQ Gora; Iniciativa: “Më shumë të drejta në pronësi”; Fshati Prevallac në Komunën e Prizrenit (5,952.00 €)

Fondi i Grave të Kosovës i RrGGK-së ofron grante të vogla për organizatat e grave që nuk kanë qasje në burime të tjera të financimit dhe të cilat kërkojnë të punojnë për të drejtat e grave, veçanërisht në mesin e grupeve nga vendet rurale dhe/apo grupeve të marginalizuara. Që nga viti 2012, FGK ka përkrahur 103 organizata, në shumën prej 295,092.10 €. Në vitin 2016, Fondi i Grave të Kosovës po mbështetet nga Austrian Development Agency (ADA) dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.